



VERUGIA s.r.l.
(Saverio IANDIORIO)



**AKT - KONTRATE
- THEMELIMI)**

**PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
" EURO - GREN "**

Sot ne date, ...23:11...1994,

Fabrika e Masureve dhe e furcave ,Tirane, si person juridik shqiptar , me qender (seli) ne Tirane, me adrese : Rruga " Sabaudin Gabrani " ; e perfaqesuar nga drejtor ing, zonja Gjinovefa Turku

dhe

Shoqeria "Verugia" - sh.p.k. e regjistruar me vendimin nr 5310, date ..4.7.1994, te gjykates se rrethit te Tiranes, me qender (seli) ne Tirane ,me adrese : "Sabaudin Gabrani", Kombinati i drurit "Misto Mame", e perfaqesuar nga administratori i saj ,zoti Saverio Iandriorio, me banim te perhershem ne Avellino Itali me adrese: Rruga Pianodardine - 88- 83100.

Arriten ne marreveshje per krijimin e shoqerise se perbashket shqiptaro - italiane, sipas llojit ; SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne republiken e shqiperise, sipas kushteve qe vijojne:

NENI 1

Emertimi dhe Qendra (selia)

1.1 Emertimi i shoqerise eshte : Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar "Euro - Gren" ose shkurt "Euro - Gren" sh.p.k.

1.2 Qendra (selia) e shoqerise do te jete : Rruga "Sabaudin Gabrani", Kombinati i drurit "Misto Mame", Tirane, Shqiperi.

Tel:26926
fax:26926

NENI 2

Qellimi i Shoqerise

2.1 Shoqeria krijohet me qellim qe te ushtroje aktivitetin sipas objektit qe pasqyrohet ne nenin tre te kesaj kontrate ne territorin e Republikes se Shqiperise ashtu edhe ate jashte saj.

NENI 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise

3.1 Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :



prodhimi,perpunimi tregetimi ekspotrimit dhe importimi i materialeve te gjitheshfarellojshme gjysem fabrikate per druri,te lendes se sharruar,te artikujve te tornuar e te profiluar,te makinerive te perpunimt te drurit e te organizimit te kryerjes se transportit per te njejtat mallra

3.2 Shoqeria mund te kryej operacione komerciale, industriale,financiare,shitje blierie pasurish te ~~shpallur~~ e te patundeshme,te gjitha keto te kryera nga administratoret e ngarkuar per ndjekjen e tyre.Gjithashtu shoqeria mund te marri pjese direkt ose indirekt, me kuota, ne shoqeri te tjera ose ndermarrje qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te .

3.2 Shoqeria do te beje investime per ndertimin e objekteve te ndryshme qe i sherbejne rritjes se veprimtarise se saj ekonomiko-tregetare.

NENI 4 Regjimi juridik

4.1 Ne te gjithe veprimtarine e saj ne territorin e R.SH. shoqeria udhheqet nga legjislecioni shqipetar ne fuqi.

4.2 Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi.

4.3 Shoqeria gezon afirmim ligjor qe nga dita e regjistrimit te saj ne "Regjistrin Tregetar" te Gjykates se rrethit te Tiranes.

4.4 Te drejtat dhe detyrat e shoqerise dhe te ortakeve te saj percaktohen ne kontratat (akt themelimin) dhe ne statutin e saj.

4.5 Shoqeria mban librat kontabel ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne Republiken e Shqiperise,si dhe te dispozitave perkatese qe percaktohen ne statutin e saj.

VERUGIA s.r.l.
(Saverio TANDIORIO)





5.1 KAPITALI BAZE i shoqerise perbehet nga:

- * Kapitali ne Natyre,
- * Kapitali ne Vlere

a) Kapitali ne Natyre perbehet nga:

- 1) Kapitali ne natyre i ortakut shtetedor shqiptar FABRIKA E MASUREVE E FURCEVE Tirane, me nje vlefte prej 10561521 Lekesh, dhe
- 2) Kapitali ne natyre i Verugia sh.p.k. e regjistruar me vendimin nr. 5310 date 06.07.1994, te gjykates se rrethit te Tiranës me nje vlefte prej 29721350 Lekesh.

b) Kapitali ne Vlefte perbehet nga:

- 1) Kapitali ne vlere i ortakut shqiptar qe arrin 1300000 Leke, dhe
- 2) Kapitali ne vlere i Verugia sh.p.k. qe arrin 82000 Leke.

KAPITALI NE NATYRE E NE VLERE i ortakut shqiptar (FABRIKA E MASUREVE E FURCEVE) arrin vleren 11861521 Leke.

KAPITALI NE NATYRE E VLERE i Verugia sh.p.k. arrin vleren 29803350 Leke.

KAPITALI FILLESTAR i EUROGREN Sh.p.k. arrin vleren 41664871 Leke.

RAPORTI I PJESEMARRJES se ortakeve ne kapitalin fillestar te EUROGREN Sh.p.k. eshte:

- 1) Per ortakun shtetedor shqiptar (F M F Tirane)28.46..... %
- 2) Per Verugia Sh.p.k. e regjistruar me vendimin nr. 5310 date 06.07.1994, te gjykates se rrethit te Tiranës71.54..... %.

5.2 Diferenca ndermjet kapitalit qe Verugia Sh.p.k. do te vere ne dispozicion te EUROGREN Sh.p.k. sipas projektit dhe kapitalit qe ajo ve ne dispozicion te kesaj shoqerie qe ne momentin e themelimit eshte:

- a) Per kapitalin ne natyre3078650..... Leke.
- b) Per kapitalin ne vlere3913000..... Leke.

SHUMA = 6996650 Leke

Kjo pjese e kapitalit te Verugia Sh.p.k. do te vihete ne dispozicion te shoqerise EUROGREN Sh.p.k. deri me 15.12.1995.

Ne qofte se kjo pjese e kapitalit te VERUGIA Sh.p.k. nuk vihete ne dispozicion te EUROGREN Sh.p.k. brenda dates se siperpermendur, atehere shoqeria do te konsiderohet e zgjidhur automatikisht duke respektuar kapitalet e derdhura.

5.3 Kapitali baze i shoqerise do te rritet krahas ecurise se veprimtarise se saj ekonomiko-financiare e tregtare sipas vendimit te ASAMBLESE SE ORTAKEVE.

5.4 Kuotat jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakesh dhe te afermve te shkalles se pare. Ne te gjitha rastet e tjera kuotat mund t'u shiten te treteve pasi t'u jene ofruar me pare ortakeve te tjere dhe keta te fundit nuk kane mundur te ushtrojne te drejten e blerjes.

Kjo e drejte ushtrohet pas 30 (tridhete) ditesh nga komunikimi i ofertes se transferimit te kuotave i bere ortakeve me leter rekomande dhe konfirmim-marrje. Nese njeri nga ortakët nuk do te kryejte blerjen e kuotave te vena ne shitje atehere kete te drejte e kane ortakët e tjere, ne proporcion gjithnje me ortakët e tjere. Ne rast shitje kuotash cmimi do te mbetet i njejte me ate te tyre ne momentin e krijimit te shoqerise.

NENI 6
Drejtimi i shoqerise



6.1 Drejtimi i shoqerise behet nga keto organe :

Asambleja e ortakeve
Keshilli administrativ

6.2 Menyra e emertimit te organeve te mesiperme percaktohet dhe pershkruhet ne statutin e krijimit te shoqerise, i cili i bashkengjitet kesaj kontrate.



Neni 7

Ndarja e fitimeve

7.1 Fitimi neto ndahet midis ortakeve sipas kuotave te tyre te percaktuara ne kapitalin themeltar.

7.2 Fitimi neto i ortakut me banim te perhershem jo ne Shqiperi mund te eksportohet jashte territorit te Republikes se Shqiperise i konvertuar ne valute te huaj, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

7.3 Me vendim te Asamblese se Ortakeve fitimi mund te investohet ne teritorin e R.SH. ose ne vende te tjera ku ushtrohet veprimtaria e shoqerise.

Neni 8

Afati i veprimtarise se shoqerise

8.1 Shoqeria mund te filloje veprimtarine e saj qysh nga data e regjistrimit ne "REGJISTRIN TREGTAR" te Gjykates se rrethit te Tiranes .

8.2 Afati i funksionit te shoqerise eshte per 20 (njezet) vjet , me te drejte perseritje edhe ne te ardhmen.

8.3 Data e hyrjes ne fuqi te kontrates (Aktit Themeltar) se Shoqerise eshte ajo e neshkrimit te saj nga ortakët ne Zyren e Noterise ne Tirane.

NENI 9

Likuidimi i shoqerise

9.1 Rastet dhe procedura e likuidimit te shoqerise si edhe ajo e mbarimit te afatit te kontrates (Aktit Themeltar) percaktohen ne Statutin e saj

NENI 10

Dispozita e pergjithshme dhe e fundit

10.1 Kjo kontrate (Akt Themeltar) per themelimin e shoqerise ka si pjese perberese te saj edhe Statutin e Shoqerise, i cili i bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ne fuqi.

10.2 Adresa ligjore e shoqerise eshte :

Rruga "Sabaudin Gabrani"
Kombinati i Drurit "Mihal Duri"
Tirane
Tel.fax . + 355 42 269 26

10.3 Cdo ndryshim ose shtese qe mund t'i behet kesaj kontrate (Akti Themeltar) duhet te behet me shkrim, te nenshkruhet nga ortakët dhe te depozitohet si ne dokumentet e shoqerise (ne seli) ashtu si edhe ne "REGJISTRIN TREGTAR" te Gjykates se Rrethit te Tiranes .




VERUGIA s.r.l.
(Saverio IANDIORIO)



Kjo kontrate (akt themeltar) e shoqerise u perpilua
ne dhjete kopie te njejta nga ortaket si dhe u nenshkrua
prej tyre ne Tirane ku eshte dhe qendra(selia) e saj, sot
me, .04:02:1995.1994

ORTAKET

Fabrika e masureve dhe e furcave
perfaqesuar nga drejtor



ing. Gjinovëfa TURKU

Shoqeria "Verugia" sh.p.k.
perfaqesuar nga administrator

Saverio IANDIORIO

(Signature)
VERUGIA s.r.l.
(Saverio IANDIORIO)



NOTERIA

Nr. 456 rep.

Nr. 105 kol

V È R T E T I M

Sot, më datë 04.11. 1996 (nëntëdhjetë e ~~pesë~~) në zyrën e Noterisë Tiranë, para meje noteres u paraqitën personalisht Fabrika e Masurëve e Furçeve Tiranë, përfaqësuar nga Ing.Zj.Gjenvafa Turku dhe Z. SAVERIO TANDIORIO, madhore e e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga letër njoftimi që ata mbanin të cilët deklaruan se sa më sipër është Statuti i Shoqërisë "EUROGREN" shpk, e përpiluar jashtë kësaj zyre me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, nënshkruhet rregullishtë para meje dhe unë noterja e vërtetoj atë konformë ligjës.



NOTERË

Artur Meta

Shënim: Datat janë plotësuar me dorën time.



*Noterja
Artur Meta*



VERUGIA S.R.L.
(Saverio IANDRIORIO)

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"EURO-GREN"

Ne Tirane , sot me date 23 nentor 1994

1) Fabrika e Masureve dhe e Furcave ne Tirane, me gender(seli) ne Tirane me adrese :Rruga "Sabaudin Gubrani" , kombinati "Misto Mame" e perfaqesuar nga drejtoresha e saj ing.Gjenovefa Turku,

dhe

Shoqeria "Verugia"shpk e regjistruar me vendimin nr 5310 date 6.7. 1994 te gjykates se tiranes me gender (seli) ne Tirane,me adrese Rruga "Sabaudin Gabrani",kombinati i drurit "Misto Mame" perfaqesuar nga administratori i saj ,zoti Saverio Iandriorio me banim t perhershem ne Itali rruga Pianodardine -88-833100 Avellino.

Vendosen bashkerisht te miratojme kete statut per krijimin e shoqerise se perbashket ne baze te dispozitave te meposhteme :

KREU 1

Neni 1

1.1 Shoqeria italo-shqiptare krijohet sipas tipit SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

Neni 2
Kohezgjatja

2.1 Shoqeria "EURO-GREN"do te funksionojte per nje periudhe prejnjzet vjetesh,duke patur te drejten e perseritjes edhe ne te ardhmen.

Neni 3
Emertimi dhe qendra

3.1 Emertimi i shoqerise do te jete : Shoqeria "Euro - gren" Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ose e thene shkurt "Euro - gren" shpk

3.2 Qendra (selia) e Shoqerise : sic shkruhet ne dispoziten 1.2 te nenit no 1 te kontrates.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

4.1 Sipas nenit tre te kontrates.



VERUGIA s.r.l.
(Shoqëri e MANDIQRIO)

Neni 5
Kapitali i shoqerise
5.1 Sipas nenit pese te kontrates.

Neni 6
Regjimi juridik

6.1 Sipas nenit kater te kontrates

KREU 2

Neni 7
Te drejtat dhe detyrat e ortakeve

7.1 Ortaket jane te detyruar te zbatojne te gjitha detyrimet e cituara ne dokumentat e themelimit ,si dhe ato qe percaktohen nga Asamblea per realizimin e objektit te veprimtarise.

Neni 8
Ruajtja e sekretit

8.1 Ortaket jane te detyruar qe te mos nxjerri te te tretet te dhena dhe njoftime per veprimtarine e shoqerise qe per qe per ata kane karakter sekret .

8.2 Ortaket e percaktojne vete llojin e te dhenave dhe te informatave qe konsiderohen sekret.

KREU 3
Struktura administrative e shoqerise

Neni 9
Asamblea e ortakeve

9.1 Asamblea eshte organi me i larte i shoqerise dhe perbehet nga ortaket.

9.2 Asamblea e zakonshme e ortakeve mblidhet jo me pak se dy here ne vit.Procedura e veprimtarise se saj realizohet sic parashikohet ne ligjin no 7638 date 19.11.1994 per shoqerite traqetare.Asamblea drejtohet nga administratori ose ne rast te mungeses se tij nga personi i ngelur ne asamble i cili ne cdo rast emerton nje sekretare.

9.3 Kompetencat kryesore e orakeve :

- ben ndryshimin e statutit dhe te kapitalit themeltar
- percakton kohozgjatien e veprimtarise se shoqerise ose likujdimin e saj
- ben shnederrimin e shoqerise nga lloji me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera te percaktuara nga kodi tregetar
- asamblea vendos me unanimitet per cmimet dhe tregjet dhe ne rastet kur njeri nga ortaket ka gjetur treg te



VERUGIA S.T.I.
(Saverio IANDIORIO)

garantuar me cmime me te larta dhe pagese ne dorezim
atehere zbatohet automatikisht kjo oferte
- planet ekonomike financiare vendosen me shumice votash
pas diskutimesh te hollesishme

9.4 Ne mbledhien e saj te pare si dhe ne te tjerat ,
Asamblea mund te percaktoje edhe kompetenca te tjera si
per vete ashtu edhe per personelin tjeter administrativ.

Neni 10
Asamblea e jashtezakonshme

10.1 Behet me nismen e njerit nga ortaket ose me
propozimin e administratorit te shoqerise si dhe me
propozimin e nje esperti kontabel duke specifikuar
paraprakisht objektin, vendin, oren, daten si dhe listen e
problemeve per te cilin kerkohet te mblidhet kjo
mbledhje; duke u miratuar nga ortaket.

10.2 Jane te vlefshme edhe mbledhjet ku jane te pranishem
perfaqesuesit e te tere kapitalit.

10.3 Cdo ortak mund te perfaqesohet ne nje mbledhje te
jashtezakonshme nga nje ortak tjeter ose nga nje i trete
me prokure.

10.4 Me proceduren e mbledhjes se jashtezakonshme merren
vesh vete ortaket.

Neni 11
Administratoret

11.1 Administratori eshte organi kryesor ekzekutiv i
shoqerise i zgjedhur nga asamblea e orakeve. Ky
administrator eshte ne fuqi deri ne doreheqien e tij ose
ne shkarkim me vendim te asamblese
ortakeve. Administratori mund te rizgjidhet.

- Administratori i pare dhe perfaqesues i shoqerise me te
tretet do te jete ing. Gjini vefa Turku

~~VERUGIA S.r.l.~~
(Saverio IANDIORIO)

11.2 Na te pastajmen ,Asamblea e ortakeve mund te
plotesojat kuadrin e administrimit te shoqerise edhe me
drejtues e organike plotesuese, ne perputhje me nevojat
per realizimit te detyrave dhe te objektit te
veprimtarise.

11.3 Kompetencat e administratorit i vendos Asamblea e
ortakeve ne mbledhien e saj te pare me dokumenta te
vecante. Administratori eshte i veshur me pushtetin e
administrimit te zakonshem . Ai nuk mund te permbushe
detyrat e administrimit te jashtezakonshem (shitje-
blerie pasuri te patundeshme, financiare, debitime) pa
aprovimin e Asamblese se ortakeve .



VERUGIA S.T.I.
(IANDIORIO)



VERUGIA S.T.I.
(Saverio LANDORIO)

Neni 12
Veprimtaria ekonomike

12.1 Veprimtaria ekonomiko - tregëtare e shoqërisë realizohet dhe garantohehet në bazë të legjislativës në fuqi në R.SH. (vecanerisht nga dispozitat e kodit tregëtar dhe ligjeve për investimet e huaja)

12.2 Për detyrimet e veta në qarkullimin tregëtar e juridik me persona të tjerë shoqëria përgjigjet me pasurinë e vet.

12.3 Aktivi dhe pasiv i veprimtarisë së shoqërisë pasqyrohet në planet e saj ekonomike e financiare të shprehura në lek ose në valute të huaja gjë që vendoset nga ortaket.

12.4 Pasuritë e shoqërisë vlerësohen nëpërmjet bilanceve ekonomike - financiare të saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

12.5 Të ardhurat e shoqërisë pasi zbriten shpenzimet e amortizimit të pasurisë dhe shpenzimet e tjera që behen në interes të saj ndahen midis ortakëve sipas kushteve të përcaktuara në kontratë apo të marrëveshjeve që mund të bëjë Asambleja në të mirë të zhvillimit dhe të zgjerimit të veprimtarisë së shoqërisë.

12.6 Për detyrimet shoqëria përgjigjet me fondet e saj.

12.7 Shoqëria është disponuese dhe përdoruese e pasurisë së vet. Në përputhje me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së saj ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë edhe aksione të personave të tjerë.

12.8 Objektet dhe mjetet e përdorimit shoqëria i siguron sic do të vendos Asambleja.

Neni 13
Llogaria e shoqërisë

13.1 Llogaria rrejedhese e shoqërisë do të jetë në Bankën Italo-shqiptare me qendër në Tiranë. Shoqëria mund të çelë llogari edhe gjetkë.

Neni 14
Viti ekonomik

14.1 Viti ekonomik fillon në janar dhe mbaron në dhjetor të çdo viti kalendarik, kurse ai për vitin 1994 në kohën e fillimit të veprimtarisë dhe përfundon në 31.12.1994.

Neni 15
Dhënia e llogarise ekonomike


15.1 Shoqëria funksionon në bazë të dispozitave ligjore ekonomike në fuqi në R.SH. si dhe të dokumentave të krijuar të saj.



VERUGIA s.r.l.
(Saverio MANDICORIO)

-5-

15.2 Veprimtaria ekonomike e shoqerise mbeshtetet ne llogaritje e prodhimit dhe te tregtimit si dhe ne vetfinancimit qe mbulon shpenzimet e veta duke perfshire edhe ato ne valute.



15.3 Per nxitjen ekonomike te veprimtarise se shoqerise krijohen fonde rezerve dhe fonde te tjera te vecanta sipas vendimeve qe do te arrijne ortaket.

15.4 Mbajtia e kontabilitetit te shoqerise do te behet sipas rregullave, metodave dhe teknikave kontabel, veprimeve qe kryen ajo si dhe te ngjarjeve qe ndodhin gjate ushtrimit te veprimtarise se saj.

15.5 Format e organizimit te kontabilitetit do te zgjidhet nga vete ortaket duke patur parasysh qe te siguroje : regjistrim te hollesishem dhe kronologjik te te gjitha veprimtarise dhe te ngjarieve qe trajtohen ne kontabilitet - ruajtjen e te dhenave dhe disponimin e tyre ne cdo kohe - pergatitien e dokumentave permbledhese te parashikuara ose te kerkuara - kontrollin e saktesise se te dhenave te trajtuara.

15.6 Cdo forme organizimi te kontabilitetit qe do te perdoret do te jete e tille qe te mundesoje kryerjen e kontrollit te jeshtem ne menyre te tille qe cdo ekspert te nxjerre nga librat kontabel, brenda nje kohe te arsyeshme ,nje pamie te pergjithshme te veprimeve te kryera dhe te gjendies se shoqerise.

15.7 Kontrolli i perditshem kontabel dhe statistikor behet ne base te dispozitave ligjore qe veprojne ne R.SH. dhe ato qe percaktojne vet ortaket.

Neni 16
Raporti vjetor

16.1 Paraqitet ne formen dhe permbajtjen e caktuar ne nenin 211 te ligjit no 7638 ,date 19.11.1992. per shoqerite tregtare.

16.2 Perfundimet vjetore ekonomiko - financiare nxirren nepermjet bilancit ,jo me vone se tre muaj nga mbarimi i vitit ekonomik.

16.3 Te drejten e kontrollit dhe te informimit per cdo veprimtari te shoqerise e ka sejcili nga ortaket .

Neni 17
Kontrolli kontabel



1 Shoqeria mban librat kontabel per te regjistruar te gjitha veprimtarine e saj , ne perputhe me udhzimet e pergjithshme kontabel.

17.2 Dokumentacioni kontabel kontrollohet cdo vit nga ekspertet qe emerohen nga ortaket dhe veprojne ne perputhie me legjislacionin ne fuqi ne R.SH.

17.3 Ne qofte se e shikon te arsyeshme Asamblea e ortakeve mund e caktoje edhe eksperte te huaj kontabel.

Neni 18

Financimet e shoqerise

18.1 Shoqeria mund te marre financime per nxitjen e veprimtarise se saj sipas vendimit te asamblese.

Neni 19

Ndarja e fitimit te shoqerise

19.1 Behet ne perpjestim me kapitalin baze te shoqerise. Per kohen kur ortaket nuk kane sjelle ne shoqeri pjese te kapitalit ne natyre ose vlere, sic parashikohet ne kontrate, perpjestimi caktohet mbi bazen e raporteve provizore te pjesemarrjes ne kapitalin baze.

19.2 Nga ortaku i huaj fitimet mund te transfarohen jashte shqiperise.

19.3 Fitimet ortaket mund t'i riinvestojne per zhvillimin e metejshem te veprimtarise se shoqerise.

KREU 5

Neni 20

Rastet e nderprerjes se veprimtarise se shoqerise

20.1 Nderprerria e veprimtarise se shoqerise behet kur vertetohen arsye serioze sic parashikohen nga legjislacioni ne fuqi ne R.SH. kur vetetohen kushtet e forzes madhore, kur varferohet shoqeria, kur del nje vendim nga organet kopetente te vendit qe e ndalon veprimtarine e saj.

Neni 21

Procedura e shkrirjes

21.1 Pas nderprerjes se funksionit te saj shoqeria shkrihet. Per kete asamblea cakton komisionin e shkriries, nga casti i caktimit te te cilit te gjitha kopetencat e shoqerise i kalojne ketij komisioni, sipas dispozitave ne fuqi ne R.SH.

21.2 Komisioni i shkriries caktohet sipas dispozitave ne fuqi.

21.3 Anetaret e komisionit te shkriries e kryejne veprimtarine e tyre vetem bashkerisht.

21.4 Ortaku me banim ne Itali mbrohet dhe garantohet nga garancia qe i krijon atij ligji per investimet e huaja ne Shqiperi.



7-

KREU 6
Dispozita të përgjithshme

VERUGIA S.T.T.
(Saverio IANUCCI)

Neni 22

Ndryshime të favorshme në legjislacionin e R.SH.

22.1 Në qoftese në R.SH. shpallen ligje, dekrete ose vendoset një politike me të favorshme nga legjislacioni i pasqyruar në aktin dhe statutin e themelimit të shoqërisë atehere ortaket kanë të drejtë (nëse është e d.m.d) t'u drejtohen organeve përkatëse shtetërore që të zbatojnë legjislacionin me të favorshëm. Në të kundërt d.m.th kur shpallen ligje e rregulla të ~~dës~~ favorshme, ortaku me banim në Itali mbrohet nga garancia që përmendet në nenin 21 (dispozita 21.4) e këtij statuti.

Neni 23

Personeli i shoqërisë

23.1 Personeli administrativ dhe ai teknik i shoqërisë vendoset sic do ta shohin të arsyeshme orataket d.m.th me vendas ose të huaj.

Neni 24

Mosmarrevshiet

24.1 Mosmarrevshiet që mund të lindin midis ortakeve do të zgjidhen kryesisht me bisedime e mirekuptim. N.q.se kjo nuk do të mund të arrihet, atehere ortaku i interesuar mund t'i drejtohe gjykates së rrethi të Tiranës ose edhe organeve të tjera me të larta kompetente, kur nuk është dakort me zgjidhjen që vendoset.

Neni 25

Dispozita të vecanta

25.1 Për çështje që nuk parashikohen në këtë statut, veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në legjislacionin përkatës në fuqi në Shqipëri.

25.2 Ky statut i përpiluar nga ortaket në 10 (dhjetë) kopje të barabarta hyn në fuqi qysh nga momenti i nëshkrimit të tij prej tyre.

25.3 Krahas persosies së metejshme të legjislacionit tregëtar në R.SH. asamblea e ortakeve ke të drejten e përmiresimit të metejshëm ~~dhe~~ të dispozitave të kontrates dhe të këtij statuti.

25.4 Statuti i mesiperm nënshkruhet në Tiranë, ku është dhe qendra e shoqërisë, sot me datën, 04.02.1995. ~~1994.~~

ORTAKET

Fabrika e masurave dhe furçave
Përfaqesuar nga drejtori

